

AKT THEMELIMI
&
STATUT I SHOQËRISË TREGTARE TË SË DREJTËS SHQIPTARE

Eden spa SH.P.K

KREU I

THEMELIMI, EMRI, AKTIVITETI, KOHËZGJATJA, SELIA.

NENI 1

Data e themelimit, Emri, Emërtimi tregtar dhe Ortaku Themelues

Sot, më datë: 29 /06/2021, Ortaku i Vetëm Themelues, krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) me emrin "**Eden spa**" SH.P.K

Emërtimi tregtar i shoqërisë është "**Eden spa**".

Ortaku i vetëm Themelues i Shoqërisë është: Besmir Karaj, i biri i Ramazan-it, nenshtetas gjerman, i dtl. 30.05.1986, lindur ne Tirane - Shqipëri, dhe banues ne Gjermani, mbajtes pasaportes biometrike gjermane Nr. CBY9H17HZ qe eshte leshuar nga autoritetet gjermane ne dt. 29.05.2015 me date mbarimi 28.05.2025;

NENI 2

Qëllimi - Aktiviteti tregtar

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet tregtar si më poshtë: Ofrimin e shërbimeve estetike, ofrime te shërbimeve te fizioterapisë, shitje/blerje me pakice & shumice, import & eksport, ofrimi ne treg i produkteve estetike; Shoqëria mund te themeloje dege te saj, zyra përfaqësimi, shoqëri te tjera tregtare, mund te marre pjese si ortake ne shoqëri te tjera te çdo forme ligjore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Shoqëria mund te shtojë ose pakesojë aktivitetin e saj ne fusha te tjera ekonomike me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise.

NENI 3

Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar kohor.

NENI 4

Selia

Selia kryesore e shoqërisë ndodhet në Tiranë-Shqipëri, në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 64, Hyrje 8, Kati 2-të, Ap. 2, Njesia Nr. 5, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të regjistrojë dhe adresa dytesore ne territorin shqiptar.

KREU II

KAPITALI

NENI 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë **Eden spa** SH.P.K është **1,000,000 (një milion) lekë** dhe ndahet në 1 (një) kuotë.

Vlera nominale e 1 (një) kuote është **1,000,000 (një milion) lekë.**

Piesëmarrja në kapitalin e shoqërisë: Ortaku i vetëm themelues Besmir Karaj, zotëron një (1) kuotë me vlerë nominale 1,000.000 **(një milion)** lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë.

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme e cila mbledhet për këtë qëllim dhe vendos sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij statuti.

NENI 7

Tjetërsimi i kuotes/kuotave

Kuota e vetme e kapitalit të shoqërisë mund të tjetërsohen nga Ortaku i Vetëm nëpërmjet:

- a) shitblerjes;
- b) dhurimit;
- c) me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

Asambleja e Përgjithshme

Të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme i takojnë dhe ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë dhe miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- i. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ii. investimet të çdo lloji dhe vlerë monetare;
- iii. ndryshimet e statutit;
- iv. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- v. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- vi. përcaktimin e shpërblimit të administratorit si dhe të likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- vii. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- viii. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ix. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- x. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- xi. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- xii. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- xiii. dhënien e kredive të tretë,
- xiv. shpërndarjen e fitimeve vjetore,
- xv. për të gjitha veprimet e tjera për të cilat është vendosur kufizim kompetene ndaj administratorit të shoqërisë.



Ortaku i Vetëm është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkeljet e Statutit dhe ligjit.

NENI 9 **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga ortaku i vetëm dhe/ose nga administratori i shoqërisë dhe mbledhet, si rregull, në selinë e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret me shkresë ose nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit (e-mail) dhe thirrja duhet të përmbajë përmbajtje vendin, datën, orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës. Ajo mund të mbledhet gjithashtu dhe në çdo vend tjetër, si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe të aksesueshëm lehtë nga pjesëmarrësit, si në selinë e Ortakut të Vetëm.

Administratori i shoqërisë nuk mund të përfaqësojë me autorizim ortakun e vetëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 10 **Kompetenca në vendimmarrje**

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë e përbërë nga Ortaku i Vetëm, është organi i vetëm vendimmarrës i saj. Proçedura në marrjen e vendimeve, mbajtjen e proçesverbaleve të mbledhjeve etj., i përshtatet natyrës së organizimit të shoqërisë si "SHPK me Ortak të vetëm". Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë merren me vetëm miratimin/nenshkrimin nga Ortaku i Vetëm.

NENI 11 **Administratori - Mandati i Administratorit**

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë.

Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet dhe fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB sipas legjislacionit në fuqi. Mandati i administratorit të shoqërisë mund të rinovohet për një afat tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratorja e parë i shoqërisë do të jetë: *znj.* JOANA SALLIU, e bija e Artan, shtetase shqiptare, e dtl. 26/01/1996, lindur në Tiranë, mbajtëse e Kartes se Identitetit Nr. 032618097, me Nr. Personal **J65126041K**, me datë lëshimi 11/09/2014 dhe datë skadence 10/09/2024, me adresë banimi në Tirane - Shqipëri.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, ushtrohen sipas dispozitave ligjore të ligjit 9901/14.04.2008 «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare» të ndryshuar dhe, Kodin e Proçedurës Civile.

Administratori humbet mandatin e tij me dorëheqje. Administratori mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, për shkaqe të arsyeshme, duke bërë njoftim paraprak, në një kohë të përshtatshme, për të mundësuar vazhdimësinë normale të veprimtarisë së shoqërisë dhe vazhdimin e veprimeve nga Ortaku i Vetëm dhe/ose nga administratori i ri i caktuar, me përjashtim të rasteve kur dorëheqja e menjëhershme vlerësohet e justifikuar për një arsye të rëndësishme. Për këtë arsye, administratori thërret Asamblenë e Përgjithshme dhe dorëzon kërkesën e tij për dorëheqje. Dorëheqja prodhon efekte pas pranimit të saj me vendim të Asamblesë.



NENI 12

Kompetencat e Administratorit – Kufizimet e kompetencave

Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe në tagrat e tij përmbahen veçanërisht dhe në mënyrë pershkruese si me poshte;

- i. Përfaqësimi i shoqërisë kundrejt palëve të treta,
- ii. menaxhimin e punëve të përditshme të shoqërisë, duke zbatuar politikat e vendosura dhe të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme,
- iii. hapja e llogarive bankare të shoqërisë,
- iv. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të inventarit, dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- v. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë për miratim;
- vi. raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- vii. zbaton vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë,
- viii. kompetenca të tjera që i njeh ligji.

Kufizimet e Kompetencave të administratorit: Administratorja e shoqërisë është e kufizuar në terheqje cash nga llogaria e shoqërisë deri në shumën 200,000 (dyqind mijë) leke ose në ekuivalentin e kësaj vlere në valute tjeter. Për terheqje cash mbi këto vlere, do të duhet miratimi i meparshem i Ortakut të Vetem të shoqërisë.

NENI 13

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për veprime apo mosveprime me faj, të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- i. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi,
- ii. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- iii. të vlerësojë më përgjegjësi çështjet, të cilat janë në kompetencat që i janë dhene nga statuti i shoqërisë dhe nga ligji;
- iv. të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, (prezent apo të mundshëm), të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- v. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e imponuar nga detyra e tij.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhen në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

KREU IV

Viti Financiar – Bilanci – Fitimet – Likuidimi – Prishja e shoqërisë



NENI 14
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Viti i parë financiar i shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe mbyllet më 31 Dhjetor të vitit 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë).

NENI 15

Eksperti kontabël

Administratori është përgjegjës, për mbajtjen e saktë e të rregullt të inventarit, të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë, për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe të raportit e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe, për paraqitjen e tyre, bashkë me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, përpara Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë për miratim.

Për këtë arsye, pajton me kontratë shërbimi, një ekspert të fushës së kontabilitetit (kontabilist/financier – person fizik ose juridik). Kontabilisti/financieri merr përsipër të ofrojë shërbimet e tij në bazë të kontratës me shoqërinë. Kontrata e shërbimit duhet të përfshijë detyrimin e financierit: *të bëjë periodikisht dhe sipas ligjit deklaratimet para organeve tatimore, qendrore dhe të qeverisjes lokale, të Sigurimeve Shendetësore & Shoqërore për të punësuarit e shoqërisë dhe të njoftojë për këtë arsye dhe për pagesat brenda afatit ligjor, administratorin e shoqërisë, të kontrollojë të gjitha dokumentet kontabël të aktivitetit ekonomik dhe tregtar të shoqërisë, të hartojë bilancin vjetor dhe t'i paraqesë përpara administratorit për miratim më pas nga Asambleja e Përgjithshme, të ushtrojë kontrolle shumëvjeçarë dhe periodikë në rastet kur kjo detyrë i ngarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.*

Të gjitha raportet e kontabilistit i njoftohen administratorit dhe më pas ky i fundit ia dërgon për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 16

Bilanci vjetor

Bilanci vjetor duhet të paraqitet te organet tatimore pasi të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, brenda datës 31 Mars të çdo viti pasardhës ose sipas parashikimeve ligjore ne fuqi ne cdo vit financiar.

NENI 17

Fitimet

Fitimet që realizon shoqëria, i shpërndahen Ortakut të Vetëm, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo moment, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë. Për këtë arsye emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, një likuidator me tagra të përcaktuara në ligj. Likuidatori është përgjegjës si ndaj shoqërisë ashtu dhe ndaj të tretëve. Ai shpërblehet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 19

Baza Ligjore



Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, Kodit Civil dhe çdo ligji të veçantë të Republikës së Shqipërisë.

NENI 20
Mosmarrëveshjet

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente Gjykatat Shqiptare.

NENI 21
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e rregjistrimit në (QKB) Qendrën Kombëtare të Bisnesit.

Nenshkrimi

Ortaku i Vetëm Themelues i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

"Eden spa" sh.p.k

Besmir Karaj

